

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Rrëzimi i akuzave për 'krime kundër njerëzimit' në Hagë, prokurorja West: Vendimi do të analizohet me kujdes
ADRESA	https://www.gazetatema.net/rajoni/rrzezimi-i-akuzave-per-e-kunder-njerezimit-ne-hage-prokurorja-west-ven-i586526
BURIMI	gazetatema.net
GJENDJA	redirected

KOHA


KAPUR NGA NE	16 shtator 2026, 15:33:36 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	16 shtator 2026, 15:40:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	8ff3e58d31cd2d90cd5efdc87395c3ae499d5a0a71257b52924aec888d2668d8
TEKSTI	91cac56998b5b462ae5e7f7d9fbaa86859c1eec54ea1cbb9ad14a928f1870781
PAMJA	0205360d799a8b9c9c5d0b735e8516d57d1d978c2f992061670ac25e365a1a25

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	e7c747205bc730b262e9da721e834f410f432b0d9c5e46c8f6a18d97f92ed00a
E MËPARSHMJA	—
RRËNJJA MERKLE	c11531ba0c325ce57cb42979570286028b15ce78f5f30478d991f53d7430dd86
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/e7c747205bc730b262e9da721e834f410f432b0d9c5e46c8f6a18d97f92ed00a>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



- [Politika](#)
- [Sociale](#)
- [Kronika](#)
- [Ekonomia](#)
- [Editorial](#)
- [Antena](#)
- [Blog](#)
- [Rajoni](#)
- [Bota](#)
- [Kulturë](#)
- [Sport](#)
- [Lifestyle](#)

 English

Built and Monetized by 

[Kontakt](#)



 English



16 Kanadaja ftohet te behet 'anetarja e pare e asociuar' e BE-se5 gola ne 4 jave, Shpendi "terbon" italiane, por emri i del edhe ne AngliPromovohet novela e Fate Velajt ne Pogri fundit

Prëzimi i akuzave për 'krime kundër njerëzimit' në Hagë, prokurorja West: Vendimi do të analizohet me kujdes



16 Shtator 2026, 17:40Rajoni TEMA



Prokurorja e Specializuar, Kimberly Eest, e përshëndeti aktgjykimin ndaj katër ish-krerëve të UÇK-së, duke e cilësuar atë një vendim të rëndësishëm për sundimin e ligjit në Kosovë dhe për drejtësinë ndaj viktimave.

"Gjykata ka konfirmuar se asnjë individ, pavarësisht rangut apo autoritetit politik, nuk është mbi ligjin dhe nuk ka imunitet nga përgjegjësia për krime të rënda ndërkombëtare", tha Eest, sipas një njoftimi për media.

Sipas saj, ZPS-ja "nuk ka ndjekur penalisht UÇK-në" dhe as "luftën e bërë për pavarësinë e Kosovës".

"Individë të caktuar shfrytëzuan ato rrethana të luftës për të kryer krime të rënda, dhe është për meritë të Kosovës që këta individë nxirren tani para përgjegjësisë", tha Eest.

Prokurorja Eest po ashtu tha se ZPS-ja do të shqyrtojë të gjithë aktgjykimin në ditët në vijim, përfshirë pikat e aktakuzës për krime kundër njerëzimit "që nuk çuan në dënime".

Njoftimi i plotë

"Prokurorja e Specializuar, Kimberly West, e mirëpriti aktgjykimin e shpallur sot në gjyqin ndaj Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit, duke e cilësuar atë të rëndësishëm për sundimin e ligjit në Kosovë dhe për drejtësinë, edhe pse të vonuar, për viktimat.

Trupi gjykues konstatoi se secili prej katër të akuzuarve mban përgjegjësi penale individuale për krimet e luftës të arrestimit dhe ndalimit të paligjshëm ose arbitrar, trajtimin mizor, torturës dhe vrasjes. Hashim Thaçi u dënua me 25 vjet burg, Kadri Veseli me 18 vjet, Rexhep Selimi me 13 vjet dhe Jakup Krasniqi me 25 vjet.

"Vendimi i sotëm, i bazuar vetëm në fakte dhe në ligj, është i rëndësishëm për llogaridhënien dhe sundimin e ligjit në Kosovë. Gjykata ka konfirmuar se asnjë individ, pavarësisht rangut apo pozitës politike, nuk është mbi ligjin dhe nuk ka imunitet nga përgjegjësia për krime të rënda ndërkombëtare", tha Prokurorja e Specializuar.

West theksoi se çështja e ngritur nga Zyra e Prokurorit të Specializuar kishte të bënte me përgjegjësinë penale individuale dhe nuk vinte në diskutim asnjë narrativë historike.

"Zyra e Prokurorit të Specializuar ka mbajtur përgjegjës individë për veprimet e tyre, në përputhje me mandatin e saj, asgjë më shumë. Zyra nuk ka ndjekur penalisht Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës dhe as luftën e bërë për pavarësinë e Kosovës. Individë të caktuar shfrytëzuan rrethanat e luftës për të kryer krime të rënda dhe është për meritë të Kosovës që këta individë po mbahen tani përgjegjës", vijoi ajo.

Gjatë paraqitjes së çështjes, Zyra e Prokurorit të Specializuar paraqiti dëshmitë e 125 dëshmitarëve në sallën e gjyqit, ndërsa rreth 3.000 prova në disa gjuhë u pranuan si prova materiale.

Në aktgjykimin e saj, trupi gjykues konstatoi se Hashim Thaçi, Kadri Veseli, Rexhep Selimi dhe Jakup Krasniqi janë fajtorë për arrestimin dhe ndalimin e paligjshëm ose arbitrar të të paktën 385 personave, trajtim mizor ndaj të paktën 49 personave, torturën e 303 personave dhe të paktën 96 vrasje.

Sipas njoftimit, këto krime u kryen ndaj qindra civilëve dhe personave që nuk merrnin pjesë në luftime, nga prilli 1998 deri më 20 qershor 1999, në komuna të ndryshme të Kosovës dhe në dy rrethe të veriut të Shqipërisë.

Prokurorja e Specializuar bëri të ditur gjithashtu se Zyra e Prokurorit do ta shqyrtojë me kujdes të gjithë aktgjykimin gjatë ditëve në vijim, përfshirë edhe gjashtë pikat e aktakuzës për krime kundër njerëzimit që nuk çuan në dënime.

Në fund, Zyra e Prokurorit të Specializuar ritheksoi angazhimin për të siguruar llogaridhënie dhe për të mbështetur të drejtat e viktimave, ndërsa procesi gjyqësor kalon në fazat e ardhshme."

Lini një Përgjigje

Koment *

Emër *

POSTOJE KOMENTIN

Dënimi i ish-krerëve të UÇK, DASH: Shmangni retorikën nxitëse, punoni për një të ardhme paqësore

17:00 Rajoni

"Dënim skandaloz," Grenell shpërthen pas vendimit për Thaçin: Gjykata Speciale duhet të mbyllet, Kurti të veprojë menjëherë

16:20 Rajoni

[Tension pas verdiktit të Hagës, protestuesit thyejnë xhamat e bazës së EULEX-it, bllokohet rruga Prishtinë–Fushë Kosovë](#)

16:00 Rajoni / 2 komente



Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.